

BAZA LIGJORE DHE PROCEDURA E NDJEKUR PER SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE:

- 1- Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikave dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin nr.21, date 18.3.2009, pasi mori ne shqyrtim aplikimet e paraqitura nga KESH sh.a., TEC Vlore, OST sha. dhe CEZ Shperndarje, *me Vendimet e Bordit te Komisionereve nr. 62, nr.63, nr.64, nr.65, nr.66 te dates 13.09.2010*, vendosi fillimin e procedurave per percaktimin e tarifave respektive te aktiviteteve te energjise elektrike, vendime te cilat jane publikuar ne *Fletoren Zyrtare*.
- 2- Duhet permendur qe aplikimet e bera jane publikuar ne gazete dhe se ERE ka qene e hapur dhe ka vene ne dispozicion materialet e aplikimeve per te gjitha palet e interesuara, si dhe duke i publikuar ato edhe ne faqen zyrtare te internetit te ERE www.ere.gov.al.
- 3- Bazuar ne Vendimet e mesiperme per fillimin e procedurave te shqyrtimit te kerkesave per rishikimin e tarifave dhe cmimeve te shitjes se energjise elektrike per vitin 2011, ERE, ka pasur nje korespondence te gjere dhe intesive me keto kater shoqeri, nepermjet te ciles i eshte kerkuar paraqitja e shpjegimeve, informacioneve dhe dokumentave plotesuese lidhur me aplikimet e tyre.
- 4- Ne mbeshtetje te Rregullores se Praktikave dhe Procedurave, konkretisht te neneve 29 dhe 31 pika 1 dhe 2, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s Nr.21, date 18.03.2009, nga data 25-18 Nentor 2010 si dhe me pas ne vijimesi deri me 30 Nentor 2010, midis perfaqesuesve te ERE-s dhe perfaqesuesve te KESH sh.a./FPSH, TEC Vlore sh.a, OST sh.a. dhe CEZ shperndarje., jane zhvilluar seanca degjimore teknike lidhur me shqyrtimin e aplikimeve perkatese te shoqerive per tarifate e enegjise elektrike per vitin 2011.
- 5- Ne daten 18.11.2010, ERE, organizoi seancen zyrtare publike, ne te cilen u ftuan te merrnin pjese per te diskutuar dhe shprehur qendrimet dhe opinionet e tyre lidhur me keto aplikime te gjitha institucionet, shoqat e mbrojtjes se konsumatoreve, si dhe te gjitha palet e tjera te interesuara dhe perfaqesuese te publikut te gjere, nepermjet njoftimit i cili u publikua nga ERE ne mediane shkruar dhe vizive. Mendimet e paleve te shprehura ne kete seance u shqyrtuan nga Grupi i Punes i ERE-s i ngritur per kete qellim i cili nga analiza e kerkesave te shprehura nga palet e treta ne seance veren se pyetjet dhe

komentet e paleve ishin te nje karakteri te pergjithshem duke kerkuar te mos lejohet nje rritje abuzive dhe e paargumentuar te cmimeve te energjise elektrike, i cili do te rendonte padrejtesisht konsumatorët e rregullt familjare, Nje kerkese tjeter kishte te bente me ruajtjen e bandave te konsumit per konsumatorët familjare, te njejta me ato te periudhes se mepareshme. Persa me siper, grupi i punes duke vleresuar se kerkesat e paleve nuk bazohen ne llogaritje te shifrave, procedoi me studimin e aplikimeve ne perputhje me kerkesat e akteve ligjore dhe nenligjore , qe lidhen me percaktimin e tarifave dhe çmimeve sic pershkruhen ne kete relacion. Vlen ketu te permendetqendrimi i perfaqesuesit te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes ne seancen zyrtare publike, u shpreh ne parim per ruajtjen e nivelit tarifor me dy blloqe per konsumatorët familjare ç’ka eshte reflektuar edhe ne analizen e cmimeve dhe tarifave nga Grupi i Punes, duke respektuar edhe dispozitat e nenit 27 pika 1, germa dh, te Ligjit nr.9072 date 22.05.2003 “ Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar.

Pas realizimit te ketij procesi transparent, Grupi i Punes i ngritur nga ERE per shqyrtimin dhe miratimin e tarifave u mbeshtet dhe mori ne konsiderate parimet baze te vendosjes se tarifave te percaktuara ne:

- Deklaraten Rregullatore, miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009,
- Vendimin nr. 46 dt.14. 06.2010 “Mbi kerkesen e OSSH sh.a lidhur me nivelin e humbjeve te energjise per vitin 2008”.
- Vendimin nr.93, date 30.11.2010 “Per miratimin e programit te uljes se humbjeve totale per tre periudhat e rregullimit”.
- Vendimin nr. 77, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 78, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 59, date 29.12.2005, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes se transmetimit te energjise elektrike”;

- Vendimin nr. 79, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes te tarifes se shperndarjes te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 80, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me pakice te energjise elektrike”.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe duke qene se tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per konsumatoret fundore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga te kater shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht pergjate gjithe procesit te ndjekur nga ERE.

LLOGARITJA E TARIFAVE DHE CMIMEVE PER VITIN 2011.

BILANCI ELEKTROENERGJITIK

Ne kerkesat e paraqitura ne ERE u konstatua se te kater shoqerite nuk jane mbeshtetur ne te njejtat parashikime te kerkeses per energji elektrike per vitin 2011. Nga ballafaqimet e kryera ne seancat teknike, ERE beri me dije se baza e treguesve te bilancit energjetik mbi te cilen llogariten tarifat e sherbimeve te energjise elektrike duhet te jete e njejte. Eshte pikerisht parashikimi i kerkeses per energji elektrike, qe pergatitet nga OSSH sh.a., baza nga e cila rrjedhin dhe parashikimet e kerkeses per sistemin e transmetimit dhe te kerkeses qe duhet te permbushe FPSH ndaj FPP. Ne vijim, paraqitet bilanci energjetik i pranuar per llogaritjen e tarifave te sherbimeve te energjise elektrike per vitin 2011. Bilanci elektroenergjetik eshte ndertuar mbi bazen e roleve, pergjegjesive, dhe marredhenieve financiare te ndertuara ndermjet kater shoqerive sipas parashikimeve te Modelit Shqiptar te Tregut.

GWh	2008	2009	2010	2011
Kerkesa	4,109	4,151	4,378	4,553
Prodhimi bruto	3,720	5,192	4,267	4,250
minu konsumi vetjak	5	10	13	13
minu humbje ne prodhim	11	36	43	34
Prodhim neto	3,704	5,146	4,211	4,203
plus Prodhim nga HEC-et lokale	69	68	64	68
Shuma e Prodhimit Publik	3,773	5,214	4,275	4,271
Shitur OST per humbje	214	258	296	225
Shitur OSSH per humbje	-	286	-	-
Shitur sherbime ndihmese	-	6	-	-
Shitje/Export	59	463	-	-
Prodhimi disponibel per shitje tek FPSH	3,500	4,201	3,979	4,046
FPSH				
Prodhimi Publik	3,500	4,201	3,979	4,046
plus Prodhimi nga TEC Vlore		0	245	24
plus Prodhim nga HEC-et private	62	91	85	165
plus Importi nga FPSH	547	29	22	
import per dif te tec-it			47	
Blere nga FPSH	4,109	4,321	4,378	4,235
Shitur per FPP	4,109	4,151	4,378	4,235
	-	(170)	-	-
Energjia e levruar ne OST				
Levruar nga FPSH	4,109	4,151	4,378	4,235
Energji per humbjet e OST	214	258	296	225
Energji per humbjet e OSSH nga prodhimi	-	286	-	-
Import nga OSSH per humbje	1,927	1,947	1,705	1,547
Ekspert	59	463	-	-
levruar nga TSO per KK				300
Nga KK-Tso	11	31	100	
Shuma	6,320	7,136	6,479	6,307
OSSH/FPP				
Shitje per klientet tarifore	4,109	4,151	4,378	4,235
Per Humbjet	1,927	1,947	1,705	1,547
Per KK	11	31	100	
Shuma	6,047	6,129	6,183	5,782
minus konsumi ne TL	(197)	(182)	(250)	(240)
Energjia e Levruar ne Shperndarje	5,850	5,947	5,933	5,542

TARIFA E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER KESH SH.A.

Llogaritja e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike është bazuar në metodologjinë perkatese të miratuar nga ERE dhe mbështetur në parashikimin e prodhimit vendas neto hidro prej 4,271 GWh, si dhe përfshin të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike për KESH /Gen është propozuar 1.12 leke /kWh për vitin 2011, pra me një rritje prej 180% nga tarifa aktuale. Tabela në vijim paraqet kostot dhe vlerësimet e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për KESH sh.a për vitin 2011.

Tabela nr.2 “ Struktura e kostove dhe tarifa perkatese per KESH GEN (000 leke)

Item	Aplikuar nga Kompania	Axhustimi ndaj Propozimit te Kompanise	Propozimi I ERE
Mirembajtje	275,700		275,700
Personeli	1,170,400		1,170,400
Furnitura e Sherbime	1,139,000	152,000	987,000
Totali OPEX	2,585,100	152,000	2,433,100
Vlera e asetëve	37,567,000		37,567,000
Amortizimi I akumuluar	7,233,000		7,233,000
Vlera neto e Asetëve	30,334,000	-	30,334,000
Kapitali I Punes		202758	202,758
Investime	1,868,000		1,945,000
Amortizimi I Vitit	879,000		879,000
Baza e Rregulluar e Asetëve(RAB)	31,323,000		31,602,758
Kthimi I Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	4.50%		4.50%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	35.80%		40%
Kosto Mesatare e borxhit	3.70%		3.70%
Raporti I Synuar I Borxhit	64.20%		60%
WACC	4.0%		4.0%
Fitimi	1,248,660	21,771	1,270,431
Te ardhurat e Kerkuara	4,712,760	173,771	4,582,531
Eksport I energjise Elektrike	-	1,900,000	(1,900,000)
Te ardhurat e kerkuara minus Eksportin	4,712,760	2,073,771	2,682,531
Te ardhurat e Kerkuara Neto	4,712,760		2,682,531
Energjia e Prodhuar	4,271,300	-	4,271,300
Tarifa Mesatare e Prodhimit	1.1034		0.63

Shpenzimet Operative (OPEX)

Shpenzimet per mirembajtje

Nisur nga te dhenat historike per vitet 2008, 2009 dhe 2010, keto shpenzime luhaten ne kufijte 250 -270 milion leke. Per me teper nga kontrolli i shpenzimeve te vitit ushtrimor 2010 mendojme qe shpenzimi i pritshem ne kete ze mund te jete ne nivelin 258 milion Leke. Pretendimin e kompanise per rritje te ketij zeri rreth 8% krahasuar me ate te vitit 2010, mbeshtetet ne inflacionin si dhe nevojen per rritje te shpenzimeve te mirembajtjes per arsye te mbajtjes ne pune dhe rritjen e gadishmerise gjate dy viteve te fundit te pajisjeve dhe makinerive qe sherbejne per prodhimin e energjise elektrike, te cilat kane tejkaluar prodhimin mesatar vjetor shumevjecare. Per keto arsye, ne kushte normale te gjendjes financiare keto shpenzime jane konsideruar si te arsyeshme.

Shpenzimet per paga

Shpenzime per pagat, te kerkuara nga shoqeria jane pothuajse te njejta per vitet 2010 dhe 2011. Ky shpenzim reflekton rritjen e fondit te pages prej 4.9% si pasoje e indeksimit dhe rritjes se planifikuar te numrit te punonjesve sipas miratimit te planit financiar nga keshilli mbikqyres i shoqerise. Tabela me poshte paraqet “Numrin mesatar te punonjesve dhe pagen mesatare per vitet 2010 e 2011 (Milion Leke)”.

Tabela 3: Numrin mesatar te punonjesve dhe pagen mesatare per vitet 2010 e 2011

Nr.	Emertimi	2010				2011			
		KESH TOTAL	DVP	Qender	FPSH	KESH TOTAL	DVP	Qender	FPSH
1	Numri mesatar i punonjes gjithsej	905	713	174	18	905	713	174	18
2	Shpenzimi per personelin	1,145	782	333	30	1,202	821	349	32
a	Fond per pagat	526	355	155	16	553	373	163	16
b	Shtesat turni	73	66	5	1	76	70	6	1
c	Ushqim ditor	112	88	21	3	118	93	22	3
d	Udhetim e dieta	56	32	22	2	59	34	23	2
e	Sigurime shoqerore	128	88	37	4	135	93	38	4
f	Paga 13	44	30	13	1	46	31	14	1
g	Shpenzime te tjera personeli	206	122	79	4	216	129	83	4
	Pagat mesatare mujore per nje punonjes	48,453	41,533	74,342	72,333	50,876	43,609	78,059	75,950

“furnitura dhe sherbime”,

Lidhur me zerin e shpenzimeve “*furnitura dhe sherbime*”, kompania ne kerkesen per te ardhura ne aplikimin e saj e ka paraqitur ate per shumen 1,139 milion leke. Pas kontrollit te ketij shpenzimi si dhe shpjegimeve te bera nga kompania gjate seancave teknike te organizuara nga ana e ERE-s, propozojme qe ky ze te ulet me 152 milion leke ose me 5 % nga sa eshte propozuar nga kompania, sepse perfshin detyrimet per sherbimin e transmetimit per energjiine e eksportuar nga KESH Gen. Vlera prej 987 milion leke e ketij shpenzimi vleresohet qe eshte e aresyeshme, duke perfshire ketu indeksimin per shkak te inflacionit si dhe sherbimeve nga te tretet per mbajtjen ne gadishmeri te paisjeve, ne kushtet kur ato po punojne me kapacitet te plote.

Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Amortizimi

Amortizimi - eshte llogaritur nga KESH/GEN duke perdorur normat fiskale, sic dhe parashikohet ne metodologjiine e llogaritjes se tarifes se prodhimit te energjise elktrike. Ky shpenzim eshte llogaritur nga KESH ne vleren 879 milion leke per vitin 2011.

Bazuar ne Pasqyrat Financiare te raportuara per vitin 2009 ky shpenzim paraqitet per 766 milion leke. Duke marre ne konsiderate shtimin e aseteteve te reja per vitin 2010 dhe 2011 respektivisht me vlerat 2,022 milion leke dhe 1,868 milion leke , gjykojme qe ky shpenzim i kerkuar nga Kompania eshte i aresyeshem.

Kthimi mbi bazen e rregulluar te aseteteve-

Ne llogaritjen e Bazes se Rregulluar te Aseteve (RAB) per shumen 31,603 milion leke jane perfshire:

- asetet e reja ne shumen 2,022 milion leke dhe 1,868 milion leke qe priten te kapitalizohen respektivisht per vitet 2010 dhe 2011, sipas miratimit nga Bordi i Komisionereve e ERE-s me vendimin nr 90 dt.3.12.2009 dhe .Nr 83 dt.15.11.2010.
- Amortizimi i akumuluar deri ne 31.12.2010 per shumen 7,233 milion leke
- Amortizimi i priteshem per vitin 2011 per shumen 879 milion leke

- Kosto e kapitalit WACC eshte marre 4,02% dhe ne vlere absolute 1,270 mije leke afersisht e barabarte me vleren 1,248 mije leke te propozuar nga kompania.
- Kapitali i punes per shumen 203 mije leke. Veme ne dukje se nga ana e kompanise ne aplikim nuk eshte kerkuar nje shpenzim i tille, por bazuar ne metodologjine e llogaritjes se tarifes per Prodhuesin Publik dhe per te vepruar ne menyre te njejte me te gjithe operatoret mendojme qe ky eshte nje shpenzim i aresyeshem dhe duhet te llogaritet si pjese e RAB-it.

Te ardhurat e kerkuara per te mbuluar shpenzimet OPEX dhe CAPEX per vitin 2011, sic paraqiten dhe ne tabelen me siper, llogariten ne shumen 4,582 milion leke.

Keto te ardhura te kerkuara do te korrighohen ne zbritje per shumen 1,900 milion leke, te cilat perfaqesojne rreth 12 % te te ardhurave shtese nga eksporti i energjise elektrike te realizuar ne vitin 2010, si rrjedhoje e kushteve te favorshme hidrike.

Nga raportimet periodike te kompanise si dhe nga parashikimi i priteshem i prodhimit te energjise elektrike nga Prodhuesi Publik deri me 31.12.2010, eshte pranuar qe te realizohet nje eksport i energjise elektrike afersisht ne shumen 2,800 GWh. Ne keto kushte dhe ne zbatim te Modelit Shqiptar te Tregut, propozohet qe rreth 12 % e te ardhurave shtese nga eksporti te shkojne ne perfitim te klienteve tarifore dhe pjesa e mbetur te mbuloje borxhet afatshkurtra (overdraftet) e marra nga KESH sh.a per te mbuluar shpenzimet per blerje te e energjise elektrike te importuar ne periudhen 2007-2008 (sipas raportimit te bere nga KESH sha. Bilanci i overdrafteve te papaguara akoma me 31.12.2009 ishte 177 milion euro).

Duke reflektuar korrighimet e mesiperme, te ardhurat e kerkuara te kompanise per realizimin e aktivitetit te gjenerimit per vitin 2011 jane vleresuar ne shumen 2,682 milion leke qe i korespondojne nje tarife prodhimi te energjise elektrike 0.63 leke/kWh (54% me e larte se ajo e vitit 2010). Energjia e planifikuar per t'u shitur/transferuar tek FPSH dhe energjia e planifikuar per t'u shitur per humbjet tek OST, do te realizohet sipas kesaj tarife. Tarifa re e propozuar do te krijojte nje situatë financiare normale per realizimin e aktivitetit dhe arritjen e objektivave ekonomike nga ana e Kompanine Publike te Prodhimit (KESH)

1.1 TARIFA E PRODHIMIT TE ENERGIJISE ELEKTRIKE PER TEC VLORE SH.A.

Kompania TEC Vlore sh.a., paraqiti ne ERE kerkesen per çmimin e shitjes se energjise elektrike per periudhen Korrik- Dhjetor 2011 me ane te shkreses me Nr. 412, date 14.10.2010. Ky operator eshte licensuar per prodhimin e energjise elektrike nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me Vendim Nr 11 date 02.03.2009.

Nga shqyrtimi i informacionit te derguar me ane te kesaj shkrese u konstatuan mangesi dhe mungese argumentash per te cilat nga ana e ERE-s u kerkuar shpjegime te metejshme. Si rrjedhim kompania TEC Vlore sh.a plotesoi ` informacionin sipas kerkesave te ERE-s duke bere saktesimet e nevojshme nepermjet shkreses me Nr. Prot. 471 te date 22.11.2010.

Te ardhurat e kerkuara nga kompania per vitin 2011 jane 4,397,321 mije leke dhe prodhimi i planifikohet te jete rreth 244,440 MWh. Duke marre parasysh kostot fikse dhe variable me kete sasi prodhimi rezulton nje cmim mesatar prej 18 leke/kWh. Per arsye te voneses ne fazen e komisionimit te TEC-it , i cili akoma nuk ka perfunduar per shkak te problemeve ne sistemin e marrjes se ujit te ftohte, TEC-i gjate vitit 2010 ka prodhuar vetem 25,190 MWh energji kjo e prodhuar gjate procesit te testimi. Si rrjedhim, nuk jane realizuar shpenzimet e miratuara nga ERE ne vendimin Nr. 94 Dt 15.12.2009 "Per percaktimin e cmimit te shitjes se energjise nga TEC-Vlore sh.a. per vitin 2010".

Nisur nga realizimi faktik 9-mujor dhe parashikimi per 3-mujorin e fundit te vitit 2010, shpenzimet nga TEC-Vlora sh.a. per vitin 2010 jane raportuar ne shumen prej 1,282,149 mije leke, prej te cilave 776,876 mije leke jane shpenzime per lenden djegese ndersa pjesen tjeter e perbejne kryesisht shpenzimet per pagat e personelit dhe per shlyerjen e pagesave te interest te kredive.

Ne tabelen ne vijim paraqiten ne menyre te permbledhur te dhenat per vitin 2010 sipas Vendimit te ERE-s per 2010 dhe realizimit faktik per periudhen 2009-2010 si dhe propozimet per vitin 2011 sipas aplikimit te kompanise dhe Grupit te Punes

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Vendimi i ERE-s per Vitin 2010	Realizimi TEC 2009-2010	Aplikimi i TEC-Vlore per Vitin 2011	Propozimi i ERE-s per vitin 2011
1	Te dhena teknike					
	Fuqia e vendosur Neto	MW	97.0	97	97	97
2	Te dhena te Prodhimit dhe Konsumit					
	Gjenerimi Neto Vjetor	MWh/vit	245,522	26,326	244,440	140,179
	Konsumi vjetor i naftes gazoil 0.2 % (Diezel)	Ton/vit	43439		43,439	25,078
3	Kosto Vjetore					
	Personeli	(000) Leke	55,574	75,618	73,595	54,755
	Amortizimi total	(000) Leke	623,388	10,894	673,644	338,981
	Lende Djegese	(000) Leke	3,101,754	935,343	2,937,736	2,166,411
	Axhustimi i lendes djegese	(000) Leke				-2,166,411
	Blerje materialesh dhe produktesh	(000) Leke	247,450	2,084	23,013	15,463
	<i>Te tjera (Landlease) Furnitura Taksa</i>	(000) Leke	22,204	13,447	31,552	26,138
	O &M	(000) Leke	67,573	0	135,000	135,000
	Axhustimi i kontrates O&M	(000) Leke				-67,573
	LTSA	(000) Leke	134,102	0	80,753	80,810
	Axhustim i kontrates LTSA	(000) Leke				-134,102
	Te tjera (siguracion, publikime, pritje percjellj	(000) Leke	19,325	1,995	1,800	17,620
	Pagesat e interesit (Annuity of investment)	(000) Leke	587,572	440,028	440,028	874,391
4	Kosto Totale Fikse Vjetore	(000) Leke	4,858,942	1,479,409	4,397,121	1,341,482
	Kosto Variable/kWh	Leke/kWh	13.0		12.46	16.0

Tabela 4

Lidhur me shifrat e paraqitura ne kete tabele me poshte po japim sqarimet perkatese.

1. Llogaritja e prodhimit vjetor te energjise elektrike

Percaktimi i sasise se energjise elektrike qe parashikohet te prodhoje TEC i i Vlores gjate vitit 2011 eshte bere duke u bazuar ne:

- Faktin qe TEC-Vlora ne vitet 2011dhe 2012 do te jete brenda garancise, prandaj eshte e domosdoshme qe ne keto vite te punoje me ngarkese mundesisht maksimale me qellim qe te evidentohen dhe te riparohen nga kompania kontraktuese te gjitha difektet qe mund te cfaqen.
- Kontratat e Operimit dhe Mirembajtjes (pjesa e te ciles eshte edhe realizimi i trajnimit te specializuar te stafit te TEC-it) kerkon realizim, pasi ne qoftese TEC-i do te mbahet ne konservim dalin probleme te pageses per firmen e huaj. Kjo, per arsye se ne tregun e huaj eshte e veshtire qe te gjenden firma te disponueshme ne kohen kur nevojiten. Nderkohe edhe trajnimi i stafit do te jete me i suksesshem nese realizohet konkretisht gjate operimit te TEC-it.
- Kompania ka rezerve nga viti 2010 rreth 2,166 milion leke per lenden djegese te cilat propozohet te kalojne si shpenzime te vitit 2011.

- Komisionimi dhe marrja ne dorezim i TEC-it protet qe te behet ne 6-mujorin e dyte te vitit 2011.
- Cmimi per lenden djegese per vitin 2011 propozohet nga shoqeria 77.993 leke/liter, i njejte me ate te blerjes se realizuar ne Qershor 2010.
- Konsumi specifik i lendes djegese eshte 178.994 kg/MWh

Mbeshtetur ne sa me siper eshte pranuar qe prodhimi per vitin 2011 nga TEC Vlore te jete 140 GWh

2. Shpenzimet

Lidhur me shpenzimet, per te gjithë zerat qe jane realizuar ose do te realizohen ne Euro si : kontrata afatgjate per mirembajtjen e turbinave te gazit e lidhur me kontraktuesit e (LTSA), marreveshja per operimin dhe mirembajten (O&M), shpenzimet qe kane te bejne me shlyerjen e interesave te kredive, etj eshte perdorur kursi i kembimit 138 Leke/ Euro (sipas raporteve te Bankes se Shqiperise). Ne menyre me analitike keto shpenzime paraqiten si vijon:

2.1 Shpenzime Personeli

Nga ana e kompanise eshte kerkuar qe ky shpenzim te jete ne shumen 73,595 mije leke qe i korrespondon nje numri personeli prej 61 personash. Nisur nga Plani i Biznesit (pjese e marreveshjes se PPA-se) si dhe duke marre parasysht qe TEC-i nuk do te punoje gjate gjithë vitit, propozohet qe numri i punonjesve te jete 48 persona, aq sa u pranua edhe ne Vendimin e ERE-s per vitin 2010, ne te cilin eshte pranuar nje fond page prej 55,574 mije leke. Duke bere indeksimin per inflacion (3%) dhe korrigjimin lidhur me VKM per pagen e 13 shpenzimet e personelit rezultojne te jene rreth **54,755 mije leke.**

2.2 Amortizimi

Shpenzimet e amortizimitperfshin kryesisht amortizimin e objektit per 6-mujorin e dyte te 2011. Meqenese kompania nuk ka marre ende ne dorezim objektin per shkak te voneses te komisionimit, nuk rezulton nje vlere e e pasqyryar ne librat e llogarive e si rrjedhim kemi konsideruar vleren prej 96.6 milion Euro te projektit dhe nje jetegjatesi prej 20 vjetesh. Duke marre ne konsiderate edhe shumen prej 5,711 mije

leke per amortizimin e llogaritur nga shoqeria per investimet e kryera per punonjesit e saj rezulton qe amortizimi per vitin 2011 te jete **338,981 mije leke**.

2.3 Lenda Djegese

Gjate periudhes 2009-2010 TEC-Vlora sh.a. ka shpenzuar 935,343 mije leke per lende djegese nderkohe qe mbetet nje shume e pashpenzuar prej 2,166,411 mije leke nga vlera e shpenzimeve per lende djegese te njohura nga ERE ne tarifen e vitit 2010, e cila propozohet qe te kaloje ne shpenzimet per vitin 2011.

Nisur nga fakti qe ky shpenzim eshte planifikuar dhe pranuar nga ERE ne kerkesen per te ardhura per vitin 2010, do te bejme axhustimin per te njejten shume totalin per te ardhura per vitin 2011.

2.4 Blerje materialesh dhe produktesh

Ky ze shpenzimi qe perfshin pjese kembimi, materiale ndihmese, karburant, kancelari, propozohet ne vleren 15,463 mije leke. Ketu perfshihen kryesisht 13,473 leke per blerje kimikatesh, 1,500 mije leke blerje karburanti per automjetet, 200 mije leke per pagesat e taksave lokale, etj.

2.5 Operim dhe Mirembajtje (O&M)

Bazuar ne planin e biznesit ne te cilin eshte marre parasysh eksperienca dhe praktika per TEC-e me te njejtat karakteristika si TEC-Vlora eshte parashikuar qe kompania te lidhe nje kontrate 3-vjecare me shoqeri nderkombetare te specializuara per Operimin dhe Mirembajtjen. Ne informacionin e paraqitur nga kompania ky shpenzim propozohet te jete 135,000 mije leke. Lidhur me kete shifer u kerkuan sqarime. Nga ana e kompanise u derguan dokumentat e tenderit te anuluar ne vitin 2010 si dhe rekomandimet e firmes konsulente Colenco. Sqarojme se kompania po vazhdon me proceduren me negociim ne lidhje me prokurimin e ketij sherbimi.

Mbeshtetur ne argumentat e mesiperme propozohet qe te njihet ne tarife shuma prej **135,000 mije leke** per vitin 2011 per kontraten O&M.

Kjo shifer do te axhustohet per shumen e pashpenzuar prej **67,573 mije leke** qe ERE i pranoi kompanise ne vitin 2010 per kontraten O&M.

2.6 Sherbimi i Turbinave te Gazit (LTSA)

TEC-i Vlore pritet te nenshkruaje nje marreveshje afatgjate sherbimi per turbinat e gazit, e cila parashikohet te lidhet per nje periudhe prej 12 vjet. Sipas planit te biznesit te hartuar nga kompania konsulente shpenzimet per komponentet fiks dhe variabel per vitin 2009 (te marra ne konsiderate per te njejtat arsye te permendura me lart per kontraten O&M) parashikohet te jene respektivisht 585,583 EUR dhe 745134 EUR. Ndersa kompania, ne aplikim per kete ze parashikon nje shpenzim prej 80,753 mije leke vetem per komponentin fiks me arsyetimin se TEC-i eshte brenda periudhes se garancise. Nisur nga arsyetim i kompanise lidhur me periudhen e garancise propozohet qe te merret ne konsiderate komponenti fiks i parashikuar ne Planin e Biznesit ne shumen prej **80,225 mije leke**.

Kjo shifer do te axhustohet per shumen e pashpenzuar prej **134,102 mije leke** qe ERE i pranoi kompanise ne vitin 2010 per kontraten LTSA.

2.7 Te tjera

Ketu parashikohen shpenzime per siguracione, publikimet e dokumentave te tenderit dhe pritje percjellje qe TEC-Vlora i propozon ne shumen 1,800 mije leke. Per 2011 kompania nuk ka propozuar shifer per sigurimin e objektit. Sipas planit te biznesit te hartuar nga konsulentet e huaj eshte parashikuar qe siguracioni vjetor te jete ne shumen 607,200 mije leke. Per vitin 2010 ERE ka pranuar nje shifer prej 16,120 mije leke ne perputhje me nivelin e tregut aktual shqiptar te sigurimeve. Shpenzimet e sigurimit te objektit qe te pranohen me te njejten vlere te njohur ne tarifen e vitit 2010.

Nisur nga realizimi faktik i vitit 2010, shpenzimet per publikim jane pranuar ne shumen 1,500 mije leke per vitin 2011. Si rezultat, keto shpenzime do te jene ne shumen **17,620 mije leke**.

2.8 Pagesat e interesit

Shuma e parashikuar nga kompania per kete ze prej 440,028 mije leke ka te beje me shlyerjen e kredive te marra nga Banka Boterore (BB), Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (E.B.R.D) dhe banka Europiane per Investime (E.I.B) per ndertimin e TEC-it .

Nisur nga plani i shlyerjes se kredive nga bankat e sipercituara rezulton qe principali per vitin 2011 eshte 682,365 mije leke. Ndersa interesi eshte ne shumen 525,295 mije leke. Nisur nga fakti qe principali perdoret per mbulimin e amortizimit te TEC-it, kemi llogaritur shumen neto te principalit qe do t'i lejohet kompanise ne llogaritjen e cmimit te shitjes se energjise elektrike ne shumen 349,096 mije leke. Si

rezultat shuma qe propozohet te perfshihet ne tarifen e vitit 2011 per kete ze eshte **874,391 mije leke.**

2.9 Investime per punonjesit

Shoqeria ka planifikuar qe gjate vitit 2011 te kryeje investime si platforme per sigurimin e serverave dhe 250 mije leke dhe softe te ndryshme profesionale ne shumen 200 mije leke, te cilat ishin planifikuar edhe ne shpenzimet e vitit te kaluar. Keto shpenzime kompania i ka perfshire ne menyre te parregullt ne parashikimet e shpenzimeve operative per vitin 2011. Per kete arsye kjo vlere eshte zbritur nga shpenzimet operative.

Bazuar ne llogaritjet, arsyetimet dhe axhustimet e siperpermendura propozohet qe:

Te ardhurat e kerkuara per mbulimin e kostove fikse per aktivitetin e TEC-Vlora sh.a. per vitin 2011 te jene **1,341,482 mije leke.** Kosto variabel te jete te jete **16 leke/kWh**

TARIFA E SHERBIMIT TE SHITJES ME SHUMICE TE ENERGIJISE ELEKTRIKE NGA FPSH

Perllogaritjet e tarifes nga ana e Furnizuesit Publik me Shumice (FPSH-se) jane bere duke marre ne konsiderate parashikimet me te fundit te treguesve tekniko financiare per vitin 2011. Llogaritja e tarifes se sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike krahas kostove qe shoqerojne veprimtarine normale te saj, permban mbulimin e te gjitha kostove te huave afatshkurtra (overdrafteve) te marra nga KESH sh.a. ne vitet 2007 – 2008 per importin e energjise elektrike, si dhe shlyerjen e principalit te ketyre overdrafteve te cilat pas rinegocimeve te herepashereshme parashikohen te jene te pagueshme brenda vitit 2011. KESH sh.a. kerkon mbulimin e kostove te mesiperme duke paraqitur dy skenare te ndertuar mbi bazen e:

- a) Mbulimit te kerkeses se OSSH-se ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët fundore nga TEC-i Vlore ose nga importi dhe pagimit te 50% e overdrafteve brenda 2 vjetesh sipas te cilit kerkohet nje tarife furnizimi per FPSH-ne prej 3.97 leke/kWh
- b) Pagimit te plote brenda nje viti (2011) te overdrafteve te marra nga KESH sh.a per pagesat e importit te energjise elektrike te periudhes 2007-2008, sipas te cilit kerkohet nga FPSH sha, nje tarife prej 5.31 leke/kWh.

Tabela e meposhteme paraqet llogaritjet e shpenzimeve dhe tarifes per Furnizuesin Publik me Shumice (FPSH) per vitin 2011.

Tabela 5 Zerat e Kostove dhe Tarifa perkates per FPSH per vitin 2011

Zerat	Aplikuar nga Kompania	Axhustimi ndaj Propozimit te Kompanise	Prpozimi I ERE
Blere energji nga Prodhuesi Publik	4,051		4,046
Cmimi I prodhimit te energjise elektrike -leke/kW	1.10	(0.48)	0.63
Kosto Totale e Prodhimit Publik-(000 leke)	4,469,691		2,541,034
Imortet e Energjise -GWh	-		-
Kosto e Importit - leke/kWh			-
Kosto totale e importit	-		-
Blerje energjie nga PVE- GWh	165		165
Cmimi I PVE - leke/kWh	6.89		7.10
Kosto Totale e PVE- 000 leke	1,136,850		1,171,500
Blerje energjise nga TEC-Vlore-GWh	246	(222)	24
kosto e TEC-Vlore leke/kWh	19.80		16.00
Kosto Totale e TEC -Vlore- 000 leke	4,870,800		384,000
Kosto Totale e Energjise -000leke	10,477,341	-	4,096,534
Shpenzime per personelin	32,000		32,000
Materiale	2,000		2,000
Furnitura e Sherbime	8,000		8,000
Shpenzime per interesa	772,000		772,000
Amortizimi	-		-
	-		
Kosto fikse TEC-Vlore			1,341,000
Totali I te Ardhurave te Kerkuara	11,291,341		6,251,534
Marzhi I Fitimit (0.5% e te ardhurave te kerkuara)	52,387		27,188
Totali I te Ardhurave te Kerkuara-000 leke	11,343,728		6,278,722
Energjia e Prodhuar	4,271,300		4,235,000
Tarifa e FPSH-se leke/kWh	2.66		1.48

Sic duket qarte dhe nga tabela e mesiperme, korigjimet e kryera nga grupi i punes ne lidhje me te ardhurat e kerkuara nga FPSH konsistojne ne:

- Korigjimin e sasise se energjise elektrike dhe tarifes per sasine e energjise se blere nga Prodhuesi Publik(KESH).
- Korigjimin e sasise se parashikuar per shitje tek FPP-ja.
- Reduktimin e energjise te parashikuar qe te blihet nga nga TEC-Vlore me 24 GWh nga ai i parashikuar 246 GWh.
- Mbulimin e te gjithave kostove fikse per TEC –Vlore ne shumen 1,341 milion leke nga 1,663 milion leke per vitin 2010.
- Korigjimin e cmimit te energjise te blere nga hidrocentralet e vegjel me kapacitete deri ne 15 MW nga 6.85 leke/kWh ne 7.1 leke kWh (mesatarja e ponderuar e dy kategorive te HEC-eve te vegjel ekzistuese dhe atyre te rinj bazuar ne Vendimin e ERE-s 97 (ekzistuese) dhe 101 (rinj) te 15.12.2009 qe rezulton nga ai i aplikuar ne vitin 2010.

Ne lidhje me shpenzimet e tjera operative, propozohet qe te pranohen kerkesat e kompanise, meqenese keto shpenzime jane pothuajse te njejta me ato te miratuara per tarifen e vitit 2010.

Ne te ardhurat e kerkuara per vitin 2011 konsiderohen si te aresyeshme kostot per mbulimin e kredive afatgjata te marra nga KESH sh.a per shumen 772 milion leke (sipas raportime te bera ne aplikim dhe te sqaruara gjate seancave teknike ne muajt Tetor-Nentor 2010).

Duke marre ne konsiderate te gjitha korigjimet e mesiperme, propozohet qe te ardhurat e kerkuara te FPSH per vitin 2011 te jene 6,278,722 mije leke nderkohe qe tarifa te jete 1.48 leke/kWh.